



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2020:094862

Datë: 12.07.2022

Numri i dokumentit: 03226128

PKR.nr.184/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE N GJAKOVE –Departamenti për Krime të Rënda Trupi Gjykuese i përbërë nga Gjqqtarët Shaqir Zika, Kryetar i Trupit Gjykuese, Myfera Hoxha dhe Manduhije Syla, anëtare të Trupit Gjykuese, me procesmbajtësen Nushe Kadrija – sekretare juridike, në lëndën penale kundër të akuzuarve J. N. nga fshati . . . , Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së dhe veprës penale të sulm nga neni 184 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-se, dhe kundër të akuzuarit J. N. nga fshati . . . , Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale të kanosjes nga neni 181 par.4 lidhur me par.1 të KPRK-së, si dhe veprës penale të sulmit nga neni 184 par.1 si bashkë kryes lidhur me nenin 31 të KPRK-së të akuzuar me aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Gjakovë-Departamenti për Krime të Rënda, me numër PP/I-nr.87/2020, të datës 29.09.2020, pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit gjyqësor me datën 11.02.2022, 04.05.2022, 14.06.2022, në prezencën e prokurores së shtetit Ardita Beqiraj-Hyseni, i dëmtuari P. N., i akuzuari J. N., dhe mbrojtësi i tij av.Korab Bokshi, nga Gjakova, sipas autorizimit në lëndë, i akuzuari J. N., si dhe mbrojtësi i të Ylli Bokshi avokat nga Gjakova, sipas autorizimit në lëndë, me datën 15.06.2022 mori dhe publikisht shpalli ndërsa me dt. 12.07.2022 përpiloi këtë:

AKT GJYKIM

Të akuzuarit:

1.J. N., i biri i S., e ëma F., e gjinisë D., data e lindjes . . . , në fshatin . . . , Komuna e Gjakovës, ku edhe tani banon, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion punëtor, i martuar, baba i 5 (pesë) fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal . . .

2.J. N., i biri i S., e ëma File, e gjinisë D., data e lindjes . . . , në fshatin . . . , Komuna e Gjakovës, ku edhe tani banon, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion punëtor, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal . . .

JANË FAJTOR

I akuzuari: J. N.

I. Pasi me pare ka siguruar dhe gjere me dt.09.08.2020 rreth orës 14:10minuta pa autorizim ka mbajtur arme dhe municion ne kundërshtim me nenin 4 parag.1 nenparag.1.1 te Ligjit për Armët te Republikës se Kosovës, te cilat me ligj kategorizohen si arme zjarri te

ndaluara, dhe atë: Një (1) pistoletë 7.65 mm me nr. serik 783993 dhe një karikator me 4 (katër) fishek kalibrit 7.65 mm ashtu me pas gjate bastisjes te shtëpisë dhe objekteve tjera përcjellëse ne fshatin . . ., Komuna Gjakovës, nga zyrtaret policor ne oborrin e shtëpisë te pandehurit ne një gyp plastike e kane gjetur dhe sekuestruar armen dhe municionin e lartcekur.

- Me çka ka kryer veprën penale mbajtja ne pronësi, kontrolle ose posedim te paautorizuar te armeve nga neni 366 parag.1 KPRK-se.

I akuzuari: J. N.

II. Me date 09.08.2020 rreth orës 14:15 ne fshatin . . ., Komuna Gjakovës ne Rr." . . ." pikërisht ne oborrin e shtëpisë te dëmtuarit kanose seriozisht te dëmtuarin P. N. ne atë mënyrë, qe pas mosmarrëveshjeve paraprake mes tyre pasi i pandehuri J. dyshonte se i dëmtuari kishte fol keq për babanë e tij gjate një mosmarrëveshje me nipin e tij M., rreth një borxhi, i pandehuri i revoltuar shkon ne shtëpinë e te pandehurit te cilit fillimisht i drejtohet me fjalët " se çka ke fole për babën tone e me pas nga brezi nxjerr pistoletën me te cilën e kanos duke i thënë “ të mbysim krejt”, duke ia drejtuar ne drejtim te tij, dhe pasi ndërhyjnë familjaret e te dëmtuarit arrin t ia largojnë nga dora armen, me q’ rast tek i dëmtuari shkakton frike dhe ankth.

- Me këtë, ka kryer veprën penale, te kanosjes, nga neni 181, par. 4 lidhur me par.1, te KPRK-se

Të akuzuarit: J. N. dhe J. N.

III.Me date 09.08.2020 rreth orës 14 :15 minuta ne fshatin . . ., Komuna Gjakovës ne Rr." . . ." pikërisht ne oborrin e shtëpisë te dëmtuarit ne bashkëkryerje me dashje e përdorin forcën ndaj këtu te dëmtuarit P. N. ne atë mënyrë i dëmtuari i cili ishte liruar nga ndalimi policor pasi hynë ne shtëpi, fillimisht i pandehuri J.e me pas edhe i pandehuri J. te cilët pasi e pyesin se çka ke fol për babën tone dhe kure i dëmtuari tenton te kthehet ne shtëpi te pandehurit e sulmojnë ku i pandehuri J.i ja ka kap dy duart te cilat ja vendos mbrapa, ndërsa J. e ka sulmuar duke e goditur me shuplaka fytyrës dhe ne pjesë tjera t' trupit.

- Me çka ne bashkëkryerje kane kryer veprën penale sulm nga neni 184 par.1 lidhur me nenin 31 te KPRK-se.

Andaj Gjykata me aplikimin e neneve 6, 7 , 17 par 1, 38, 39, 46, 47, 49 par.2, 69, 70, dhe nenit 366 par.1, 181 par.4 lidhur me par.1, neni 184 par.1-31, te KPRK-se , dhe neneve 359 par. 2, 367, 450 te KPPK-se te akuzuarit i :

G J Y K O N

Të akuzuarin J. N., për shkak te veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, si në Dispozitivin I të akuzës ti shqiptohet **Dënimi me Gjobë** në shumë prej gjashtëqind (600) Euro, ndera për Dispozitivin III të akuzës, për veprën penale të sulmit nga neni 184 par.1 si bashkë kryes lidhur me nenin 31 të i shqiptohet **Dënimi me Gjobë** në shumë prej treqind (300) Euro,

Konform nenit 76 i shqiptohet **Dënimi Unik me Gjobë**, në shumë prej nëntëqind (900) Euro, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar ta paguaj në afat prej tre (3) muajve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj dënimin me gjobë atëherë gjykata të akuzuarit i zëvendëson dënimin me gjobë prej nëntëqind (900) Euro, me dënim me burgim, në kohëzgjatje prej dyzetepesë (45) ditëve, duke llogaritur për çdo ditë të kaluar në burgim, shuma njëzet (20) Euro.

Të akuzuarin J. N., për shkak të veprës penale të kanosjes nga neni 181 par.4 lidhur me par.1 të KPRK-së, ti shqiptohet **Dënimi me Burgim**, në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet po që se i akuzuari në periudhën e verifikimit prej një (1) viti, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, po që se vije deri tek revokimi i dënimit me kushte në këtë dënim do të llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga data **09.08.2020 e gjerë me datën 21.08.2020**, ndërsa për veprën penale të sulmit nga neni 184 par.1 si bashkë kryes lidhur me nenin 31 ti shqiptohet **Dënimi me Gjobë** në shumë prej treqind (300) Euro, të cilin dënim është i obliguar të paguaj në afat prej pesëdhjetë (15) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj dënimin me gjobë atëherë gjykata të akuzuarit i zëvendëson dënimin me gjobë në shumë prej treqind (300) Euro, në kohëzgjatje pesëdhjetë (15) ditëve duke llogaritur për çdo ditë të kaluar në burgim, shuma prej njëzet (20) Euro.

Të akuzuarit J. N. i konfiskohet Një (1) pistoletë 7.65 mm me nr. serik 783993 dhe një karikator me 4 (katër) fishek kalibrit 7.65 mm, si objekt i veprës penale.

Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, këto armë dhe municion duhet të shkartohej nga policia e Kosovës, me bashkëpunim me Prokurorinë Themelore në Gjakovë, pasi që të vërtetohet se këto armë nuk janë përdorur më ndonjë krim tjetër.

Obligohen të akuzuarit që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën me nga pesëdhjetë (50) Euro, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumën me nga pesëdhjetë (50) Euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, Departamenti për Krime të Renda, ka ngritur aktakuzën PP/I-nr.87/2020, të datës 29.09.2020, të akuzuarve J. N. nga fshati . . ., Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së dhe veprës penale të sulmit nga neni 184 par.1 si bashkëkryerje lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe kundër të akuzuarit J. N. nga fshati . . ., Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale të kanosjes nga neni 181 par.4 lidhur me par.1 të KPRK-së, si dhe veprës penale të sulmit nga neni 184 par.1 si bashkë kryes lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestare me datë 10.02.2021, ku prezent ka qenë përfaqësuesi i akuzës Prokurori i Shtetit Ramiz Buzhala, J. N., si dhe mbrojtësi i tij av. Korab Bokshi nga Gjakova, i pandehuri J. N. si dhe mbrojtësi i tij av. Ylli Bokshi, nga Gjakova, dhe të njëjtit janë deklaruar të pafajshëm, për veprat penale sipas aktakuzës.

Gjykata në këtë çështje penale ka mbajtur shqyrtimet gjyqësore pas konfirmimit të aktakuzës, ku të akuzuarit janë deklaruar të pafajshëm, dhe janë administruar provat e administruara si në aktakuzë.

Prokurorja e shtetit Ardita Beqiraj – Hyseni, në fjalën e saj përfundimtare ka deklaruar se gjatë shqyrtimeve gjyqësore në këtë çështje penale në provat personale dhe materiale të administruara siç janë: raporti i oficerit policor L. S. i datës 09.08.2020, lista e armës së sekuestruar e datës 09.08.2020, raporti i bastisjes dhe foto albumi i po të njëjtës datë, deklarata e dëshmitares M. N., dëshmia e të dëmtuarit P. N. të dhënë në prokurori dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe po ashtu nga mbrojtja e të akuzuarve, gjatë procedurës para penale në Polici dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, në tërësi u vërtetua se të akuzuarit kanë kryer veprat penale me të cilat tani janë akuzuar, të përshkruara si në dispozitivet e kësaj aktakuze.

Me provat e lartcekura u vërtetua pa asnjë mëdyshje se të akuzuarit J. dhe J. N., në bashkëveprim kanë kryer veprën penale të sulmit nga neni 184 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, i akuzuari J.veprën penale të kanosjes nga neni 181 par.4 lidhur me par.1 të KPRK-së, si dhe i akuzuari J. veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Gjatë shqyrtimit të fundit gjyqësor, sa i përket pikës I të Dispozitivit, të akuzës për veprën penale mbajtja në pronësi kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, i akuzuari J., ka pranuar fajësinë dhe kjo fajësi është vërtetuar edhe me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, po ashtu i akuzuari J.pranon se ka sulmuar me shuplakë të dëmtarin- axhën e tij, ndërsa për veprën penale të kanosjes për të cilën akuzohet i akuzuari J.si dhe për vapën penale të sulmit për të cilën akuzohet i akuzuari J. si bashkë kryes, konsiderojmë se gjatë shqyrtimit gjyqësor u vërtetua në tërësi se të njëjtit ti keni kryer këto vepra penale, këtë më së miri e vërteton deklarata e dëshmitares M. N., e cila në këtë deklaratë shumë k jaret dhe bindeshim ka përshkruar veprimet e tyre.

Nga mbrojtja e të akuzuarve u provua se të akuzuarit kanë pasur mosmarrëveshje me të dëmtuarin, kjo gjë vërtetohet edhe me faktin se të njëjtit me palën e dëmtuar kanë arritur një marrëveshje mbi pajtim, ku i dëmtuari në prezencën e ndërmjetësve i ka falur dy të pandehurit, djemtë e vëllait të tij. Gjykata nuk duhet ti falë besimin mbrojtjes së tyre për faktin se kjo mbrojtje është e pa bazuar dhe në kundërshtim të plotë me provat materiale dhe personale, dhe se konsideroj se është bërë me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale juridike.

Nga të lartcekurat kërkojmë nga gjykata që të akuzuarit të shpallen fajtorë dhe të dënohen sipas ligjit si dhe të obligohen në kompensimin e shpenzimeve procedurale.

I dëmtuari P. N., në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se e mbështes fjalën përfundimtare të prokurores së shtetit, dhe shton se ndaj të akuzuarve nuk i bashkëngjitëm ndjekjes penale dhe nuk parashtron kërkesë pasurore-juridike, pasi që të njëjtëve rastin iu kam falur.

Mbrojtësi i të akuzuarit J. N. av. Korab Bokshi në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se i mbrojturi imë ka pranuar fajësinë sa i përket veprës penale mbajtja në pronësi kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, andaj gjykata duhet të ketë parasysh këtë pranim të fajësisë që në seancën e shqyrtimit fillestar i cili pranim është refuzuar nga ana e gjykatës.

Prokuroria në këtë çështje penale nuk ka arritur të argumentoi fajësinë për veprën penale të kanosjes nga neni 181 par.4 lidhur me par.1 të KPRK-së. Fillimisht duhet theksuar se aktakuza për nga kronologjia, orientimi në vend dhe me kohë ka të meta serioze. Në pikën II të aktakuzës, pretendohet se i akuzuari J.me 09.08.2020, në ora 14:15 minuta, ka kryer veprën penale të kanosjes, ndërsa në dispozitivin III të akuzës pretendohet se në të njëjtën datë të njëjtën orë të akuzuarit J.dhe J., kryen veprën penale të sulmit. Shtrohet pyetja si është e mundur që edhe në

minutat e njëjta të kryejnë dy vepra penale, dhe se pretendimet e akuzës bazohen vetëm në deklaratën e të dëmtuarit e cila është konfuze dhe në asnjë fazë të procedurës deklarimi i tij nuk ka qenë i njëjtë, andaj gjykata nuk duhet ti fali besimin e dëshmisë së të dëmtuarit P., pasi që deklarata e tij ka ndryshuar në të gjitha fazat e procedurës.

Po ashtu, gjykata gjatë shqyrtimit gjyqësorë dt. 14.06.2022, sipas propozimit të prokurorisë ka vendosur të lexoi dëshminë e dëshmitares M. N., e cila ishte marr në pyetje në Prokurori me datë 11.09.2020, me arsyetimin se e njëjta nuk mund të sigurohet, për dëshmi në shqyrtim kryesor. Pasi që gjatë procedurës hetimore kjo deklaratë nuk ishte siguruar konform nenit 132 të KPPK-së dhe si e tillë nuk mund të përdorë si provë e drejtpërsëdrejti gjatë shqyrtimit gjyqësorë, pasi që mbrojtja nuk ka mundur ta ballafaqoi dhe sfidoi dëshmitaren, konsideroi se gjykata nuk mund të pranoi atë deklaratë si provë të pranueshme mbi bazën e së cilës mund të mbështes aktgjykimin.

Duhet theksuar se gjatë shqyrtimit gjyqësor ka dhënë mbrojtje dhe i akuzuari J., andaj i propozoi gjykatës që mbrojtjes së tij ti fali besimin e plotë, e cila mbrojtje ka kontinuitetin gjatë gjithë fazave të procedurës, është në përputhje të plotë me dëshminë e dëshmitarit okularë Z. N., i cili është dëgjuar gjatë shqyrtimit gjyqësorë, po ashtu është në përputhje të plotë edhe me mbrojtjen e të akuzuarit J.

Gjykata duhet të aplikoi standardin më të lartë në pranimin dhe bazimin e aktgjykimin në provat fajësuese për vendimmarrje, prova të tilla duhet të merren në mënyrë ligjore dhe duhet të vërtetojnë fajësinë e të akuzuarit përtej çdo dyshimi të bazuar.

Sa i përket pranimit të fajësisë lidhur me veprën penale mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paaautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPPK-së, në marrjen e vendimit gjykata duhet të merr parasysh rrethanat posaçërisht lehtësuese, të parapara me nenin 70 par.3 të KPPK-së, pranimin e fajësisë, moshën e re, keqardhjen e shfaqur, si dhe me të dëmtuarin janë pajtuar dhe kanë lidhur marrëveshjen e pajtimit me shkrim.

Andaj gjykatës i propozoi që në kuptim të nenit 364 par.1 pika 1.3 të KPPK-së, të bije aktgjykim lirues për të akuzuarin J., për veprën penale të sulmit nga neni 184 par.1 lidhur me nenin 31 të KPPK-së, ngase nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

I akuzuari J. N., në fjalën e tij përfundimtare, deklaroi se në tërësi e ka përkrahur fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij dhe nuk ka tjetër çka të shtoj.

Mbrojtësi i të akuzuarit J. N. av. Ylli Bokshi në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se i mbrojturi imë ka pranuar fajësinë që në shqyrtim fillestar sa i përket veprës penale të sulmit nga neni 184 par.1 lidhur me nenin 31 të KPPK-së, ndërsa nuk ka pranuar fajësinë për veprën penale të kanosjes nga neni 181 par.4 lidhur me par.1 të KPPK-së. Prokuroria në këtë çështje penale nuk ka arritur të argumentoi fajësinë për veprën penale të kanosjes, pasi që pretendimet e akuzës bazohen vetëm në deklaratën e të dëmtuarit, e cila është konfuze dhe në asnjë fazë të procedurës nuk ka qenë e njëjtë, andaj gjykata nuk duhet ti fali besimin dëshmisë së të dëmtuarit P. N., pasi që dëshmia e të njëjtit ka ndryshuar në të gjitha fazat e procedurës, deri në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 04.05.2022, i dëmtuari ka deklaruar se këtu të mbrojturit tim i ka pa një “kabëll e zezë” në dorë. Po ashtu gjatë shqyrtimit gjyqësorë të datës 14.06.2022, sipas propozimit të prokurorisë gjykata ka vendosur të lexoi dëshminë e dëshmitares M. N., e cila ishte marr në pyetje në prokurori me datën 11.09.2020, me arsyetimin se e njëjta nuk mund të sigurohet, për dëshmi në shqyrtim kryesorë. Theksoi se lidhur me deklarinin e dëshmitares M. N., në Prokurori, mbrojtja, për faktin se deklarata e dëshmitares gjatë procedurës hetimore nuk është

siguruar konform nenit 132 të KPP-së, dhe si e tillë nuk mund të përdoret si provë e drejt për së drejtë gjatë shqyrtimit gjyqësorë. Andaj dëshmia e sajë ka reputacion të ulët sa i përket re avancës. Pala e dëmtuar gjatë shqyrtimit gjyqësorë ka theksuar se dëshmitarja ish bashkëshortja e tij i ka shkëputur marrëdhëniet bashkëshortore, dhe se e njëjta i ka lanë 5 fëmijë dhe ka ikur në drejtim të panjohur, andaj duhet vlerësuar kredibilitetin e dëshmisë së sajë, pasi që e njëjta i ka lënë 5 fëmijë, në mëshirën e fatit.

I mbrojturi imë nuk ka pasur armën në momentin e konfrontimit me axhën e tij këtu të dëmtuarit P., e ka konfirmuar dhe dëshmitari Z. N., në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 11.02.2022, i njëjti ka deklaruar se “këtu J., nuk ka pasur armë në momentin kur ka ndodhur kjo kacafytje”, këtë rrethanë e ka konfirmuar dhe i bashkë akuzuari J. në të gjitha fazat e procedurës, që në momentin e kacafytjes asnjëri prej tyre nuk kanë pasur armë, andaj gjykata duhet ti fali besimin deklaratave të dëshmitarit Z. dhe të akuzuarit.

Sa i përket pranimit të fajësisë lidhur me veprën penale të sulmit nga neni 184 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, në marrjen e vendimit gjykata të merr parasysht rrethanat posaçërisht lehtësuese, pranimin e fajësisë, moshën e re e këtu të akuzuarit, keqardhjen e shfaqur, si dhe i dëmtuari me të akuzuarin janë pajtuar, dhe kanë arritur marrëveshjen e pajtimit edhe me shkrim.

Përfundimisht konsideroi se gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor është vërtetuar përtej çdo mëdyshje se këtu i akuzuari JoZ., nuk ka ndërmarr asnjë veprim të ndaluar me Ligj, sa i përket veprës penale të kanosjes nga neni 181 par.4 lidhur me par.1 të KPRK-së. Andaj i propozoi gjykatës që në kuptim të nenit 364 par.1 pika 1.3 të KPPK-së të bije aktgjykim liruës për të mbrojturin tim.

I akuzuari J. N., në fjalën e tij përfundimtare, deklaroi se në tërësi e ka përkrahur fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij dhe nuk ka tjetër çka të shtoj.

Meqenëse të akuzuarit J. N. dhe J. N., nuk e kanë pranuar fajësinë për kryerjen e veprave penale për të cilën akuzohen gjykata për vërtetimin e gjendjes faktike gjatë shqyrtimit gjyqësorë i ka administruar këto prova: ka dëgjuar dëshmitarët – të dëmtuarin P. N., dëshmitarin Z. N., ka lexuar dëshminë e dëshmitares M. N., si dhe ka administruar provat materiale të propozuara nga palët dhe atë: raporti fillestar i incidentit, të oficerit policor E. H. me numër 2020-EA-92 të datës 09.08.2020, raporti i oficerit L. S., PK#10247, e datës 09.08.2020, ka bërë shikimin në listën e armës së konfiskuar nga oficeri K. H. dhe M.A., e datës 09.08.2020, si dhe ka bërë shikimin në foto albumin e Njësisë së Forenzikës, në vendin e ngjarjes dhe fotot nga arma e sekuestruar, si dhe ka dëgjuar mbrojtjen e të akuzuarve J. N. dhe J. N..

Dëshmitari – i dëmtuari P. N., gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: me datë 09.08.2020, rreth orës 14:00/h, është kthyer nga Policia, pasi që ka qenë në mbajtje, për shkak të një dënimi të pa paguar, dhe pasi që është kthyer në shtëpi, është takuar me fëmijët e tij në oborr, dhe diku 10 metra larg oborrit të shtëpisë kanë qenë djemtë e vëllait, J.i dhe J., më kanë pyetur se ku keni qenë, i kam kthyer përgjigje “ në drej të mallkuar në Polici”. Më është ofruar J., më ka thënë kam diçka me ty, i kam kthyer përgjigjen se çka ki me mua pasi jam i lodhur dhe dua të pushoi, mu ka ofruar më ka ngjitur për krahu, i kam thënë që mos të më P., çka ke me mu, pastaj ka ardhur vëllai i tij J.i i cili në dorë kishte një shafsigjer, dhe më ka goditur në bel, me ç’ rast më ka shkakuar grithje. Pas kësaj më ka ngjitur për fyti J., dhe më ka thënë “ të mbysim krejt”, Djali imë P., ka bërë duke më thënë “o babi J. ka allti në dorë”, atëherë ia kam ngjitur J.t për dorë për me e largu dhe ai më ka ra shuplakë në fytyrë, dhe jemi shty mes veti dhe kam arritur me e largu. J.i më ka kapur nga pas dhe nuk më ka lëshuar derisa ka përfunduar duke më goditur J., dhe unë kam bërë tite, e kam thirr ish bashkëshorten time e cila ka qenë në ballkon të shtëpisë, dhe i kam thënë ta thërret policinë. Bashkëshortja nuk e ka thirr policinë por e ka thirr

babin tim Z., i ka thënë Dil se djali yt me nipat e tu janë duke u mbytur mes veti, atëherë ata janë larguar në drejtim të shtëpisë tyre. Në pyetje të gjykatës se çka ka pasur J. në dorë, i njëjti ka deklaruar se unë nuk e kam parë armën por mua mu ka doke si kabëll e zezë si bejzbolli, por djali imë ka bërëtitur duke më thënë që J. ka armë dhe se J. me këtë mjet nuk më ka goditur, por më ka sjellë vetëm në duar, dhe se këtë mjetë J. në fillim nuk e ka nxjerr por të njëjtin e ka nxjerr më vonë. Kur jemi kacafytur me J.n, dhe të njëjtit gjatë kacafytjes i është shqyer bluza. Para këtij rasti, raportet me djemtë e vëllait i kam pasur të mira dhe pas ngjarjes me ndërmjetësimin e burrave, rastin iu kam falur dhe me të njëjtit jam pajtuar, andaj nuk i bashkëngjitem ndjekjes penale dhe nuk parashtroi kërkesë pasurore-juridike.

Dëshmitari Z. (P.) N., i cili në fillim të seancës është njoftuar se është dëshmitarë i privilegjuar, pasi të akuzuarit i ka nipa ndërsa të dëmtuarin e ka djalë, i njëjti ka deklaruar se do të dëshmoi është njoftuar për pasojat e dëshmisë së rreme dhe i njëjti ka deklaruar se: ditën kritike kam qenë në shtëpi dhe kam dëgjuar një bërëtimë dhe kam dal jashtë dhe e kam parë djalin tim P., e kishte kap nipin tim Z. për bluze ndërsa nipi tjetër J.i, në ato momente nuk ka qenë aty, dhe unë kam ndërhy për me i ndarë, iu kam bërëtitur të dyve, dhe e kam parë nipin J. e ka goditur me shuplak djalin tim në fytyrë, ndërsa J.i ka arritur në vendin e ngjarjes pasi unë i kam ndarë këta, dhe e ka marr vëllain e tij J.n dhe e ka qar në shtëpi. Pas kësaj djali imë P.a ka lajmëruar rastin në Polici, pastaj ka ardhur Policia, dhe policit i kam treguar se si ka ndodhur ngjarja dhe çka kam parë. Kur kam shkuar në oborr që ti ndajë, në fillim ka qenë vetëm djali P.a dhe nipi J., ndërsa më vonë ka ardhur edhe nipi J., ndërsa bashkëshorten e P., M., unë fare nuk e kam parë. Ngjarja është zhvilluar në mes të dy shtëpive, shtëpisë së J. dhe Z. dhe shtëpisë së P. Për revolen që është gjetur në shtëpinë e J., me rastin e bastisjes, unë nuk kam ditur që këta kanë revole, por këtë e kam kuptuar pasi që është bastisur shtëpia dhe për këtë revole përgjegjësi ka marr J.. Pas rasti djali imë me nipat e mi janë pajtuar dhe tani raportet i kanë të mira.

Gjykata ka lëshuar urdhëresë për sjelljen me detyrim për dëshmitaren M. N.-D., edhe për kundër dy urdhëresave të lëshuara të njëjtat nuk janë realizuar nga shkaku se dëshmitarja nga i dëmtuari P.ë, është shkurorëzuar dhe Stacioni Policorë në Klinë të njëjtat urdhëresa nuk ka mundur ti realizoi ngase të njëjtës nuk i dihet vendbanimi se ku J.. Andaj me propozim të Prokurorit gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësorë ka lexuar deklaratën e dëshmitares M. N.-D., e cila deklaratën e ka dhënë në Prokurori me datën 11.09.2020, dhe e njëjta ka deklaruar se burri imë P.a, ka qenë në mbajtje dhe ditën kritike me datën 09.08.2020, rreth orës 14:10 minuta, është kthyer në shtëpi, dhe kur ka ardhur në shtëpi fëmijët i kanë dal përpara, ndërsa unë kamë qenë brenda në shtëpi me djalin e vogël 6 muajsh, pasi që kam dëgjuar ber timen e djalit tim P., i cili ka bërëtitë “oj mami dil se e mbytën babën”, jam dalë në ballkon të katit të parë të shtëpisë dhe kamë parë duke u kacafytur J.i, ia kishte lidhur dy duart mbrapa dhe e mbante ndërsa J., e ka sulmuar duke e goditur me shuplaka dhe pasi e ka rrezuar në tokë J. e ka nxjerr armën të cilën ia ka drejtuar duke i thënë “ se këna me të mbytë krejt”, atëherë e shqetësuar kamë bërëtitur dhe e kam thirre vjehrrin tim Z.in, dhe i kam thënë “dil se u mbytën djemtë mes veti” vjehëri ka dalë dhe i ka parë duke u kacafytur dhe iu ka bërëtitur të dy palëve, ndërsa unë kam piskatë dhe i kam thënë J.i dhe J.t, se do ta thirri policinë dhe kur i kanë dëgjuar këto fjalë të njëjtit janë tërhequr dhe kanë shkuar në shtëpi të vetë. Unë kam qenë larg vendit të ngjarjes 6-7 metra, pra nga ballkoni dhe vendi ku janë kacafytur bashkëshorti me djemtë e vëllait, dhe fëmijët e mi po ashtu që të gjithë kanë qenë në oborr dhe të njëjtit kanë qenë të shqetësuar dhe kanë çarë.

Nga leximi i raportit fillestar i incidentit, të oficerit policor E. H., me numër 2020-EA-92 të datës 09.08.2020, gjykata ka vërtetuar faktin se me datë, kohë dhe lokacion, në fshatin . . . , viktimja P. N., ka lajmëruar rastin e kanosjes, dhe me këtë rast patrulla e policisë ka dal në vendin e ngjarjes, ka takuar viktimën, i cili ka deklaruar se nipat e tij e kishin rrahur dhe i kanë shkakuar lëndime, dhe për rastin është njoftuar prokurori dhe në bazë të kërkesës së prokurorit dhe urdhrit verbal nga Gjykatë, është bërë bastisja e shtëpisë së të dyshuarve J. N. dhe J. N..

Nga leximi i raportit të oficerit L. S., PK#10247, e datës 09.08.2020, gjykata ka vërtetuar faktin se, në këto raporte janë përshkruar veprimet hetimore të ndërmarra nga oficeri që ka përshkruar raportin po ashtu ka përshkruar veprimet e bastisjes, dhe se me rastin e bastisjes mbrapa oborrit të shtëpisë në një gyp plastik, është gjetur një pistoletë e kalibrit 7.65 mm, me një karikatorë dhe 4 fishekë, me ç' rast arma është konfiskuar.

Nga shikimi i listës së armës së konfiskuar nga oficeri K. H. dhe M.A., e datës 09.08.2020, gjykata ka vërtetuar faktin se nga të akuzuarit J. N. dhe J. N., është konfiskuar pistoletë me numër serik 783993, me karikator dhe 4 fishek të kalibrit 7.65 mm, dhe përgjegjësinë për revole e ka marrë i akuzuari J. N..

Nga raporti i bastisjes së forenzikës, me numër të dosjes së forenzikës FGJ-20/110, me dosjet e hetimit 2020-EA-0925 të datës 09.08.2020, është konstatuar se në këtë datë rreth orës 14:15 minuta, në fshatin . . ., kishte ndodhur një kanosje ku viktimi ka qenë P. N., ndërsa të akuzuarit J. N. dhe J. N., dhe gjatë bastisjes pas sigurimit të urdhëresës në shtëpinë e të akuzuarve jashtë shtëpisë së oborrit, mbrapa tek një gyp i azbesit, afër rrethojës është gjetur pistoletë e tipit PN, kalibrit 7.65 mm, me numër serik 783993 me një karikatorë dhe 4 fishek të kalibrit 7.65 mm, si dhe është bërë foto albumi me numër të njëjtë të rastit dhe të datës së njëjtë ku shihet shtëpia e të akuzuarve J. N.j dhe shihet vendi ku është gjetur revolva.

Nga raporti mjekësorë i lëshuar nga QKMP-ja në Gjakovë me datën 09.08.2020, nga Dr.F. I., në të cilin shkruan se ndihmë mjekësore ka kërkuar i dëmtuari P. N., dhe se pacienti ka lëndime të lehta në regjionin e barkut, dhe të njëjtit i është dhënë terapi dhe është përshkruar diagnoza, ku nga ekspertiza e ekspertit mjeko-ligjor Dr. N. H., është dhënë konkluzioni se në dokumentacionin e lartshënuar nga raporti i QKMP-së në Gjakovë, ngase kjo diagnozë nuk është e kuart, atëherë nga ky dokumentacion si i tillë nuk mund të kualifikohet si lëndim.

I akuzuari J. N., gjatë shqyrtimit gjyqësorë nuk e ka pranuar fajësinë ndërsa gjatë mbrojtjes së tij ka deklaruar se: me datën 09.08.2020, rreth orës 14:00/h, pasi që vëllai J. kishte vërejtur që ka ardhur axha P., kishte shkuar që të bisedoi dhe ti kërkoj që të mos flasë gjëra jo të sakta lidhur me babën tonë, i cili është vrarë para 8 vite. Fillimisht kam dëgjuar zhurmë dhe kur kam shkuar unë kam takuar babagjyshin Z., i cili i ka bërë titull të dyve, duke iu thënë se marre ju qoftë dhe pastaj unë e kam marrë vëllain tim dhe e kam pruar në shtëpi. Kur kam shkuar unë vëllait tim J.t, ia kam parë majicën e shqyer, dhe unë nuk kam parë se kush ia ka shqyer majicën, unë personalisht nuk kam ndërmarr asnjë veprim, dhe vëllai imë J., nuk ia kam parë që ka pasur diçka në dorë. Përpos babagjyshit tim nuk kam parë se ka pas dikush tjetër, dhe pasi që është kryer ngjarja ne jemi kthyer në shtëpi dhe axha P., ka lajmëruar rastin në polici dhe më vonë është bërë bastisja e shtëpisë dhe me këtë rast gjatë bastisjes në një gyp të plastikës prapa shtëpisë brenda në gyp është gjetur arma, dhe këtë armë unë e kam vendosur aty, dhe se kjo armë ka qenë kujtim nga baba imë i ndjerë, të njëjtën armë asnjëherë nuk e kam keqpërdorë. Pas rastit raportet me axhën tim i kemi rregulluar.

I akuzuari J. N., gjatë shqyrtimit gjyqësorë ka deklaruar se unë kam ndier do fjalë që ka folur axha imë këtu i dëmtuari P. për babën tim të vdekur, dhe unë kam shkuar të bisedoi me axhën, që të bisedoi si njeri dhe i thashë “pse morr burrë ke fole për babën tim dhe nëse ke fole tani e tutje mos fol” nga se nuk ka kuptim dhe ai më tha hec largohu more belban, duke më thënë se ai nuk ka folur dhe në këtë moment më ka shty, më ka kapur për majicë dhe e ka qitur dorën në shokë dhe në atë moment jemi kacafytur, unë i kam ra nja dy herë me dorë pra me shuplakë fytyrës, atëherë ka ardhur babagjyshi dhe na ka bërë titull dhe se kjo ngjarje ka zgjatur një deri në dy minuta, dhe në ndërkohë ka ardhur vëllai J.i, më ka marrë dhe më ka qarë në shtëpi. Unë kur kam shkuar të axha nuk kam pasur në dorë kurrgjë, dhe se ngjarja ka ndodhur në afekt, pasi që

axha më ka nervozuar me përgjigjet e tija dhe i njëjti ka mohuar se me veti kam pasur armë dhe kinse të njëjtën ia ka drejtuar të dëmtuarit dhe unë kam pasur njohuri që vëllai i tij J.i ka pasur armë në shtëpi ngase ka qenë kujtim i babës së ndjerë. pas rastit raportet me axhën i kemi rregulluar dhe jemi pajtuar me burra.

Gjykata ka vlerësuar me shumë kujdes të gjitha provat të cilat janë administruar gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor, dhe ka vlerësuar mbrojtjen e të akuzuarve si dhe deklaratat e dëshmitarëve të dhëna në Polici, Prokurori dhe në shqyrtim gjyqësor, dhe ka ardhur në përfundim se nuk është kontestuese fakti se me datë 09.08.2020, gjatë bastisjes së shtëpisë së të akuzuarit J., e cila bastisje është bërë me urdhër dhe pëlqim të Gjyqtarit të Procedurës Paraprake, i cili urdhër është konfirmuar nga Gjykata, dhe në këtë raste në shtëpinë e të akuzuarit J., është gjetur pistoleta me numër serik: 783993 me katër (4) fishekë dhe një karikatorë, të cilën armë i akuzuari J., e ka mbajtur në kundërshtim me Ligjin për Armë të Republikës së Kosovës, dhe se këtu i akuzuari ka pranuar fajësinë për këtë vepër penale.

Nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe vlerësimit të secilës provë veç e veç dhe në ndërlidhje me njëra tjetrën, me pa mëdyshje u vërtetua fajësia e të akuzuarit J. N.j, dhe atë nga deklarata e të dëmtuarit P. N., i cili në mënyrë të saktë ka përshkruar të gjitha veprimet e të akuzuarit J, ku i njëjti ka ardhur afër shtëpisë së tij, në mënyrë që të sqarohet rreth mosmarrëveshjes paraprake, që kinse ky ka folur për babën e tyre të ndjeri, gjegjësisht vëllain e tij me nipin e tyre M., rreth një borxhi, dhe këtu i akuzuari J, i revoltuar ka shkuar në oborrin e shtëpisë së të dëmtuarit, ku kanë qenë prezentë dhe fëmijët e të dëmtuarit, ku fillimisht i drejtohet me fjalët “se çka ke fole për babën tim” e më parë nga brezi nxjerr revolen me të cilën revole e kanos duke ia drejtuar në drejtim të tij, me çka tek i dëmtuari shkaktonte frikë, ankth, pasi që ndërhyne familjarët e të dëmtuarit, arrin t’ia largoi nga dora armën, ndërsa J.i në ndërkohë ka ardhur, i cili në dorë ka pasur një shafsigjer, dhe me të njëjtin e ka goditur në bel, me çrras i ka shkaktuar gërvishtje, ndërsa J. e kap për fyti dhe e kërcënon duke i thënë se do të mbytim krejt, dhe pas kësaj i ka rënë me shuplak në fytyrë. Në këtë raste ka bërë bashkëshortja e të dëmtuarit, duke i thënë se do ta thërret policinë, po ashtu e njëjta e ka thirrë babën e të dëmtuarit, dëshmitarin Z., i cili ka ardhur dhe i ka nda, djalin dhe nipat dhe çdo kush ka shkuar nëpër shtëpitë e tyre, me çrrastë i dëmtuari ka lajmëruar policinë, ka ardhur policia dhe ka bërë bastisjen e shtëpisë me çrrastë është gjetur arma.

Po ashtu nga dëshmia e dëshmitares M. Nd.-D., e cila deklaratë është lexuar në shqyrtimin gjyqësor, është vërtetuar se rasti ka ndodhur me datën 09.08.2020, në oborrin e shtëpisë së tyre rreth orës 14:00/h, ku në oborr kanë qenë fëmijët e sajë dhe pasi që ka dëgjuar ber timen e djalit të madh P.t, i cili ka bërë “oj mam dil se e mbytën babin”, e njëjta ka dalë dhe nga ballkoni i shtëpisë së katit të parë, ka parë duke u kacafytur bashkëshorti i sajë J.i ia ka lidhur dy duart mbrapa, ndërsa vëllai tjetër J. e ka sulmuar duke e goditur me shuplaka në fytyrë dhe pasi e ka rrezuar në tokë, J. e ka nxjerr armën të cilën ia ka drejtuar duke i thënë “ se kemi me të mbyte krejt”, atëherë e shqetësuar nga kjo gjendje ka bërë dhe e ka thirrë vjehrrin Z.in, duke i thënë “ dil se u mbytën djemtë në mes veti” dhe ky ka ardhur, i ka bërë të dy palëve dhe të njëjtit janë ndarë, po ashtu ka theksuar se armën gjatë kacafytjes gjersa bashkëshorti i sajë ka qenë i rrezuar në tok, ja ka drejtuar bashkëshortit të saj, dhe se bashkëshorti i saj ia ka ngjitur për armë dhe ia ka larguar armën dhe se e njëjta ka deklaruar se ka qenë larg vendit të ngjarjes 6-7 metra, dhe se ngjarjen e ka parë mirë.

Po ashtu nga deklarata e dëshmitarit Z. N., të dhënë në Polici, Prokurori dhe në shqyrtimin gjyqësor, gjykata ka vërtetuar se ngjarja ka ndodhur me datën 09.08.2020, dhe se këtu dëshmitari atë ditë ka qenë në shtëpi dhe ka dëgjuar një ber tim, kur ka dëgjuar ka dalë, ka shkuar në drejtim të vendit të ngjarjes dhe ka parë djalin e tij P., e të cilit ia kishte ngjitur dhe e ka kapur për maic J.n, ndërsa J.i ka qenë aty me ta dhe i njëjti ka ndërhy, i ka bërë të dy palëve

dhe ka parë që J. e ka goditur me shuplakë në fytyrë, ndërsa J.i ka ardhur në vendin e ngjarjes pas tij, dhe pas kësaj të njëjtit janë ndarë dhe kanë shkuar në shtëpitë e tyre. Po ashtu ka theksuar se djali i tij me nipat e tij pas rastit janë pajtuar dhe të njëjtit ia kanë falur rastin njëri tjetrit, dhe i njëjti ka deklaruar se ai nuk ka parë armë në vendin e ngjarjes por pas bastisjes së shtëpisë, J.it i është gjetur arma-pistoletë, e cila armë ka qenë e djalit tim Sokolit të ndjerë.

Gjykata hedh poshtë pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit J. N., av. Korab Bokshi, ku ka theksuar se prokuroria nuk ka arritur të argumentoi fajësinë e të mbrojturit të tij për veprën penale të sulmit nga neni 184 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ngase nga provat e administruara është vërtetuar që këtu i akuzuari J., me datë kohë dhe vend siç është përshkruar në dispozitivin II të Akuzës, së bashku me të akuzuarin J., këtu të dëmtuarit axhës së tij, e ka kapur për dy duart duke e vendosur mbrapa ndërsa i akuzuari J, e ka sulmuar duke e goditur me shuplaka fytyrës dhe pjesëve të tjera të trupit, andaj në veprimet e të akuzuarit J., formohen të gjitha elementet e veprës penale të sulmit nga neni 184 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Po ashtu gjykata ka hedhur poshtë pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit J. N. av.Ylli Bokshi, ku i njëjti ka theksuar se prokuroria në këtë çështje nuk ka arritur të argumentoi fajësinë e të mbrojturit të tij për veprën penale të kanosjes nga neni 181 par.4 lidhur me par.1 të KPRK-së, duke theksuar se pretendimet e akuzës bazohen vetëm në deklaratën e të dëmtuarit, e cila është konfize, mirëpo këto pretendime janë të pa sakta ngase këtu i dëmtuari si në Polici, Prokurori si dhe Gjykatë, i ka shpjeguar në detaje të gjitha veprimet e të akuzuarit J, i cili nga brezi ka nxjerr pistoletën duke iu drejtuar me fjalët “ të mbysim krejt” me çka me këto veprime tek i dëmtuari ka shkaktuar ankth dhe frik, dhe sipas bindjes së gjykatës kjo deklaratë e të dëmtuarit, e cila është marr në pyetje në cilësi e dëshmitarit e të cilës deklaratë i ka falur besimin e plotë dhe e njëjta deklaratë është në përputhje edhe me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësorë,

Nga analizimi i mbrojtjes së të akuzuarit J. N., i cili ka mohuar veprën penale të kanosjes por i njëjti ka theksuar se është fjalosur me axhën e tij dhe atë për arsye se axha i tij ka folur për babën e tij me nipin e tyre M., rreth një borxhi, dhe kinse baba i tyre ka një borxh, dhe unë kam kërkuar që të dalim sy me sy dhe ai nuk ka pranuar duke më thënë se nuk merrem me këto punë, atëherë i kam thënë se paske fole dhe i njëjti e ka pështy, dhe në atë moment e ka vendosur dorën në shokë dhe se ky e ka goditur me shuplakë në fytyrë dhe pas kësaj janë kacafytur dhe ky ia ka shqyer majicën, dhe nuk ka pranuar që ka nxjerr pistoletën me të cilën e ka vendosur duke ia drejtuar në drejtim të tij, mirëpo kjo mbrojtje e tij është e pa bazuar pasi që nga deklarata e të dëmtuarit P. N., i cili në mënyrë të kjart ka përshkruar të gjitha veprimet e të akuzuarit J, dhe se i njëjti e ka kërcënuar me revole, duke i thënë se të mbysim krejt, me çrrastë ka ikur i dëmtuar, ku i ka shkaktuar frik dhe ankthe. Ndërsa sa i përket veprës penale të sulmit, i njëjti edhe gjatë mbrojtjes së tij ka pranuar që i ka meshuar shuplakë këtu të dëmtuarit.

Po ashtu gjykata ka hedhur poshtë mbrojtjen e të akuzuarit J., sa i përket veprës penale të sulmit, ngase dëshmia e të dëmtuarit dhe dëshmitares M. N. është vërtetuar fakti se këtu i akuzuari J., e ka kapur të dëmtuarin P. për dy duar duke e vendosur mbrapa ndërsa J. e ka sulmuar duke e goditur me shuplaka në fytyrë, me çrraste i njëjti ka konsumuar veprën penale të sulmit, i cili fakte është vërtetuar nga dëshmia e të dëmtuarit si dhe dëshmia e dëshmitares M. N.. Andaj mbrojtja e tij është hedhur si e pa bazuar dhe e njëjta ka qenë e orientuar nga shmangia e përgjegjësisë penale.

I akuzuari J. N., sa i përket veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, për të njëjtën vepër si në seancën e

shqyrtimit fillestar dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor është deklaruar i fajshëm, ndërsa i akuzuari J. është deklaruar i fajshëm për veprën penale të sulmit nga neni 184 par.1 të KPRK-së.

Gjykata me rastin konkret ka gjetur se në veprimet e të akuzuarit J. N., formohen të gjitha elementet e veprës penale të mbajtjes në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së si dhe veprës penale të sulmit nga neni 184 par.1 të KPRK-së, ndërsa në veprimet e të akuzuarit J. N., formohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale të kanosjes nga neni 181 par.4 lidhur me par.1 të KPRK-së, sepse këtu të akuzuarit kanë vepruar me dashje direkt duke e sulmuar këtu të dëmtuarin P., ndërsa i akuzuari J., këtu të dëmtuarit ia drejton pistoletën duke e kanosur dhe duke i thënë të mbysim krejt, me çrrastë të njëjti shkaktohet ankthi dhe frika.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, që ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Përpos konstatimit të kryerjes së veprës penale, në mënyrën kohën dhe vendin e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, nuk ka gjetur rrethana rënduese, ndërsa si rrethanë lehtësuese, gjykata ka marr parasysh sjelljen korrekte të akuzuarve në gjykim, moshën e tyre të re, gjendjen ekonomike të tyre, si dhe rrethanën se i akuzuari J. ka pranuar fajësinë për veprën penale si në dispozitivin I të Akuzës, ndërsa i akuzuari J. ka pranuar fajësinë për veprën penale si në dispozitivin III të akuzës, si dhe faktin se i dëmtuari nuk i është bashkangjitur ndjekjes penale dhe nuk ka parashtruar kërkesë pasurore juridike, raportet familjare i kanë të rregulluar, këtu të akuzuarit J. i ka shqiptuar dënimin Unik me Gjobë në shumë prej 900 Euro, për dy veprat penale, ndërsa të akuzuarit J, për veprën penale të kanosjes i ka shqiptuar Dënimin me Burgim në kohëzgjatje prej 6 muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në periudhën e verifikimit prej një (1) viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale ndërsa për dispozitivin III i ka shqiptuar dënimin me gjobë, me shpresë dhe bindje se me dënimet e shqiptuara janë në harmoni me peshën e veprave penale, shkallën e përgjegjësisë penale. Prandaj duke i marr për bazë të gjitha këto gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimet e shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 41 të KPRK-së, dhe se me dënimin e shqiptuar sipas bindjes së gjykatës, është në proporcion me veprën penale të kryer dhe rrethanat personale që i posedojnë të akuzuarit dhe se me këto dënime të shqiptuar do të ndikojnë në parandalimin e të akuzuarve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, dhe do të bëhet rehabilitimi i tyre, do të parandalohen personat tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehin gjykimin shoqëror për vepër penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi konfiskimin e pistoletës me numër serik 783993, një karikator dhe 4 fishek të kalibrit 7,65 mm, është marr në bazë të nenit 366 par.3 të KPP-së.

Duke e pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe duke u bazuar në nenet 451 paragrafi 1 dhe 453 të KPP-së si dhe konform nenit 39 paragrafi.3 nënparagrafi.3.2 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, kryetari trupi gjykues ka vendosur që i akuzuari t'i paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësor si dhe shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, komfor nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
- Departamenti për Krime të Rënda -
PKR.nr.184/2020, të datës 12.07.2022

Procesmbajtësja,
Nushe Kadrija

Kryetari i trupit gjykues,
Shaqir Zika

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.